



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

SHKURT 2025

Tiranë më __.02.2025

Për dijeni: **znj.Arta Dollani**
Drejtor I Përgjithshëm

Nga: **Oltjana Telhaj**
Koordinatorë e të Drejtës për Informim

1. Nr. 1423 prot	08.02. 2025	Shoqëria V.A.L.E Recycling Shpk, me numër Nipt L28029301Q , adrese Fshati Gurez, Njësia Administrative Fushe Kuqe, Bashkia Kurbin, ushtron aktivitetin e saj ne fushën e grumbullimit, perpunimit, riciklimit e depozitimitet mbetjeje urbane, si dhe evadimit, transportit dhe perpunimit te mbetjeje te posaçme dhe mbetjeje spitalore. Me date 04.04.2024, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit eshte nxjerre Urdheri nr. 141, date 04.04.2024 "Për pezullimin e lejes mjedisore per subjektin " V.A.L.E Recycling" sh.p.k, me PN-8024-01-2019, me veprimtari "incenerimi i mbetjeje të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeje patologjike", me vendndodhje: fshati Gurez, afer ish-kanalit të acidit, Gurez, Fushë Kuqe, Laç, Lezhe", në vijim të Vendimit Përfundimtar të Kontrollit n.r AKM-DQ-2023- 0005**-5, date 07/02/2014, miratuar nga Inspektorët e	12.02. 2025	Ne vijim te komunikimit me poshte gjeni kthim pergjigje per subjektin: "Në përgjigje të kërkesës tuaj me datë 07.02.2025 dërguar me email, regjistruar në AKM me nr.1423 prot., datë 10.02.2025, ju bëjmë me dije si vijon: Në kuadër të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr.10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit" i ndryshuar, VKM nr.568/2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" të ndryshuar,	Përfunduar	Nuk ka
---------------------------	----------------	--	----------------	--	------------	--------

	<p>Agjencise Kombëtare të Mjedisit, dhe e lëne ne fuqi nga Komisioni i Ankimit me vendimin nr. 3025 prot., date 13.03.2024 per shkeljen e kushteve të lejes e supozuar nga inspektorët e AKM-se, e cila ishte mos percaktimi i sakte i instalimeve në vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit sipas lejes mjedisore qe disponon.</p> <p>Me date 25.04.2024, inspektorët e Agjencisë Kombetare te Mjedisit kryen procesin e verifikimit per permbushjen e kushtit pezullues prane shoqërisë V.A.L.E Recycling, ku u konstatua se "Gjatë procesit të verifikimi ne terren me kerkes nga vete subjekti per vendosjen e pajisjes së incineratorit te ri, u verifikua në terren vendosja e pajisjes se re incinerator..." dhe duke dale ne nje vendim perfundimtar Nr. AKM-DQ-2024-000535 - 5, date 25.04.2024, se nuk ka shkelje ligjore, pra duke certifikuar ne kete menyre permbushjen e kushtit pezullues.</p> <p>Me date 13/12/2024, u krye nje riverifikim I perbashkët nga inspektorët e Agjencise Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektorët e Inspektoratit Sheteror Teknik dhe Industrial, ku dolën në vendimin perfundimtar N.r AKM-DQ-2024-000612-5"Ne bazee te PV dhe kontestimeve te subjektit inspektimit rezulton se : Nuk ka shkelje te kerkesave ligjore, Gjatë procesit te riverifikimi ne terren me kerkesë nga vete subjekti per vendosjen e pajisjes se incineratorit te ri, nga ana e grupit të punesis i perfaqesuar nga inspektorët e Agjencise Kombëtare të Mjedisit, dhe te pranishem inspektorët e Inspektoratit Sheteror Teknik dhe Industrial bashke me administratorin e shogërise dhe drejtor/kimist u verifikua pajisja perkatese e instalimit me te dhena teknike te bazuar ne kartën teknologjike Eest Incinerator, ZMFS-50 me kapacitet 30-50 kg/ore".</p> <p>Deri ne datën e kesaj shkrese nuk kemi asnje dijeni lidhur me ecurine apo veprimet tuaja në zbatim te ligit dhe per rjedhoje bazuar ne nenin 3, 14 dhe 15 et ligjit Nr. 119/2014 "Per te drejten e informimit" mbi veprimet e metejshme te kryera nga ana Juaj lidhur me lejen mjedisore PN-8024- 01-2019. Bazuar ne nenin 3, 14 dhe 15 te ligjit Nr. 119/2014 "Per te drejten e informimit", Autoriteti Publik eshte i detyruar te</p>	<p>Në vazhdim të procedurës mbi pezullimin e lejes mjedisore të tipit A me PN-8024-01-2019 të V.A.L.E. RECYCLING shpk me Urdhrin nr. 141 datë 04.04.2024 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi, referuar kërkesave të bëra nga subjekti për plotësimin e detyrave të lëna nga grupi i inspektimit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer verifikimin në terren në ambjentet e ushtrimit të aktivitetit të Subjektit dhe bazuar në Procesverbalin e inspektimit me Nr.AKM-DQ-2024-000122-2 datë 25.04.2024 dhe listë verifikimin Nr.AKM-DQ-2024-000122-2/1 datë 25.04.2024, nga grupi i inspektimit nuk janë konstatuar shkelje ligjore duke përmbushur detyrat e lëna. Përkatësisht:</p> <p>Gjatë procesit të verifikimit në terren me kërkesë nga vete subjekti për vendosjen e pajisjes së incineratorit të ri, u verifikua në terren vendosja e pajisjes së re incinerator me te dhëna teknike kjo bazuar në kartën teknologjike Model ZMFS-50 me kapacitet 30-50 kg/orë, ku të pranishëm në këtë verifikim ishin inspektorët e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës si dhe përfaqësues të aktivitetit. Vlen për tu theksuar se gjatë ketij procesi të dyja pajisjet (incinerator) nuk ishin në punë, kjo për efekt të zbatimit të Urdhërit Nr. 141, datë 04.04.2024 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit. Procedura është finalizuar me Vendimin përfundimtar të inspektimit Nr.AKM-</p>	
--	--	--	--

	<p>veje ne dispozicion kerkuesit nje kopje te plote te informacionit te kerkuar se bashku me dokumentat justifikuese, brenda 10 ditesh pune.</p> <p>Nder te jera ju bejme me dije, se referuar nenit 3, e dreja per tu informuar eshte nje e drejte e cdo subjekti pa qene i detyruar te shpjegoje motivet.</p> <p>Refuzimi per te dhene informacion apo refuzimi i paarsyetuar i preferences se kerkuesit per menyren e dhenies se informacionit perben kundravajtje administrative dhe mbi te cilen aplikohen penalitete ne drejtim te titullarit te Institucionit, ne zbatim ne nenit 18 dhe 19 te ligjit Nr. 119/2014 "Per te Drejten e Informimit".</p>	<p>DQ-2024-000122- 5, Datë 25.04.2024 pa shkelje.</p> <p>Gjithashtu, në vijim të shkresës me nr. 7784/2 prot., datë 11.10.2024 të ISHTI-t dhe shkresës tonë me Nr.11551/1 Prot, datë 18.11.2024, është autorizuar inspektimi me Nr.AKM-DQ-2024-000612-1 datë 12.12.2024 me qëllim riverifikimin e pajisjes përkatëse të instalimit me të dhëna teknike të bazuar në kartën teknologjike model ZMFS-50 me kapacitet 30-50 kg/orë, ku të pranishëm në këtë riverifikim ishin dhe inspektorët e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial bashkë me përfaqësues të subjektit. Dokumentacioni i pajisjes së re (incinerator) është marrë në dorëzim në inspektimin e kryer në datë 25.04.2024. Kjo procedurë e verifikimit është bërë në bazë të kërkesës së operatorit dhe në verifikimin nga ana e inspektorëve ka përputhshmëri midis kartës teknologjike dhe të dhënave teknike të pajisjes. Procedura është finalizuar me Vendimin përfundimtar të inspektimit Nr.AKM-DQ-2024-000612-5, Datë 13.12.2024.</p> <p>Me Vendimin nr. Regj. Them 7505 datë 29.03.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur refuzimi i kërkesës së palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë, në çështjen e ngritur nga pala paditëse Shoqëria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke</p>	
--	--	---	--

				<p>pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024 të nxjerrë nga AKM Tiranë” kundër AKM Tiranë si palë e paditur. Cështja është në proces gjyqësor për cështjen e themelit (Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024.).</p> <p>Me Vendimin nr.80-2024-1075 datë 17.04.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur pranimi i kërkesës së palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë, në cështjen e ngritur nga pala paditëse Shoqëria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.1997/5 date 04.04.2024 e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit”, bërë më dije nga QKB me shkresën nr.3275/3 prot., datë 25.4.2024, regjistruar në AKM me nr. 4890 prot., datë 30.04.2024.</p> <p>Për sa më lart, duke qenë se Vendimi Përfundimtar i Inspektimit Nr.AKM-DQ-2023-000535-5, datë 07.02.2024 lënë në fuqi me Vendimin nr.3025 datë 13.3.2024 të Komisionit të Ankimeve si dhe Urdhri nr. 141 datë 04.04.2024 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit janë akte të kundërshtuara në gjykatën administrative, në procese gjyqësore të ndryshme dhe ende gjykata nuk është shprehur me vendim përfundimtar, në zbatim të ligjit Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar: “Neni 36 </p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.”</p> <p>si dhe ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar: “Neni 66 Çështjet paraprake 1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.”</p> <p>AKM gjendet në kushtet e pezullimit të procesit administrativ deri në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore me vendim përfundimtar.</p>		
2. Nr. 1452 prot	10.02. 2025	<p>Zonja Dollani, Ju falenderojme per letrën tuaj te dates 14.01.2025. Informacioni i marre permbush nje pjesë te kerkeses tone por vazhdon te mos jete i plote.. Ajo qe ne kemi kerkuar eshte lidhja mes Lejes së mjedisit, VNM, raportit të vetmonitorimit sipas tabelës me poshte. Kerkesa jone qendron nq plotesimin e databazit tuaj me emrin e studios qe ka bere VNM, emrin e studios qe ben raportet e vetmonitorimit, emrin e laboratorit qe kryen analizimet e parametrave, sipas tabelës të mëposhtme.</p>	14.02. 2025	<p>Në përgjigje të email-it tuaj me nr.03 Prot, datë 10.02.2025, protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me nr. 1452, datë 11.02.2025, në zbatim të Ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju bëjmë me dije si më poshtë: Bazuar në pikën 5.3.c të VKM-së Nr.568, datë 17.07.2019 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”,</p>	Përfunduar	Nuk ka

Pra, duam per secilin subjekt aktiv te vitit 2024 te plotësoni ne tabele cilët janë:

1. Studioja qe ka pregatitur VNM
2. Studioja qe ka pregatitur raportin e vetmonitorimit
3. Laboratori qe ka kryer matjet ne terren

Informacioni qe po ju kerkojme nuk gjendet ne asnje nga dokumentet apo link qe ju na dërguat!

Mbetemi ne pritje te ketij informacioni ne nje kohe sa me te shkurter!

NR	Subjekt	Tipi	Studioja e VNM	Stuido e Raporteve te monitorimit	Laboratori I Analizave

Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton databazën e lejeve mjedisore ku të reflektohen të gjitha aplikimet për leje të bëra nga subjekte të ndryshme. Informacioni që përfshihet në këtë databazë përmban të dhëna të domosdoshme për informimin e publikut apo të dhënave të hapura sipas legjislacionin në fuqi dhe përfshirja e të dhënave nga subjekte private nuk vlerësohet e domosdoshme për tu përfshirë.

Lidhur me formatin e plotësimit të databazës nuk ka akt ligjor apo nënligjor që përcakton detyrimin e AKM-së për formatin e kësaj databaze, ndaj të dhënat regjistrohen bazuar në shkresën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me nr. 4719/5 Prot, datë 29.12.2023, si dhe Udhërit Nr.92 datë 02.05.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM “Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetëmonitorimit, për subjektet e pajisur me vendim për VNM Paraprake / Deklaratë mjedisore / Leje Mjedisit të tipit A ose B”.

Gjithashtu, Ju risjellim në vëmendje se:

Lista e plotë e subjekteve të pajisura me Leje Mjedisore të Tipit A dhe B, publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, sipas linkut:

<https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/>;

				<p>Lista e plotë e ekspertëve mjedisorë të licensuar është e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sipas linkut: https://turizmi.gov.al/ekspertet-e-mjedisit/;</p> <p>Lista e plotë e laboratorëve të akredituar për kryerjen e analizave është e publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, sipas linkut: www.dpa.gov.al;</p> <p>Bashkëlidhur po ju vëmë në dispozicion për vitin 2024, si më poshtë: Database Leje Mjedisore; Database VNM; Database Monitorime Leje Mjedisore A&B.</p> <p>Referuar informacionit të dhënë ju mirëpresim pranë ambienteve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për çdo paqartësi që mund të keni.</p>		
2/1	14.02.2025	<p>Përshëndetje</p> <p>Ju falenderojmë për informacionin megjithëse jemi pak të zhgenjyer nga pergjigja juaj duke qenë se e reduktuam kërkesën tonë për shkak të volumit të madh të materialit që ju kërkuam në letrën tonë Nr. Prot. 30 të datës 02.12.2024.</p> <p>Pretendimi juaj se nuk jeni të detyruar që të mbani data base në një formë të caktuar është I drejtë, por sic e thamë më lart ne ju propozuam një zgjidhje për të reduktuar punën tuaj meqenëse e kuptojmë që është volum i madh.</p> <p>Në këto kushte do jemi të detyruar ti kthehemi kërkesës tonë të mëparshme, dhe në mirëkuptim po e reduktojmë atë kërkesë vetëm për raportet e Vetë Monitorimit të vitit 2024.</p> <p>Ju lutemi na vini në dispozicion të gjitha raportet e vetë monitorimit, përfshirë edhe raportet e analizave për</p>	18.02.2025	<p>Lidhur me kërkesen e Zj. Islami, për llogari të "Tenuis laboratories" sh.p.k., Ju bejme me dije se nga Sektori i Monitorimeve të LM dhe VNM, është grumbulluar materiali i kërkuar për vitin 2024.</p> <p>Jeni të mirepritur pranë AKM, që brenda orarit zyrtar të terhiqni materialin e kërkuar.</p>	Perfunduar	Nukka

		<p>parametrat e analizuar, për cdo subjekt që i ka dorëzuar ato pranë zyrave tuaja për vitin 2024.</p> <p>Kërkesa jonë është në bazë të ligjit Nr. 119/2014. PËR TË DREJTËN E INFORMIMI:</p> <p>“Neni 2, pika 2 e tij thotë se: "Informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.”</p> <p>Në këto kushte çdo e dhënë që ju keni prodhuar apo dispononi është subjekt i kërkesës tonë!</p> <p>Kjo kërkesë bazohet dhe në nenin 3 paragrafi 1, të ligjit të sipërpërmendur, i cili shprehet:</p> <p>“Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacion publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet”</p> <p>Informacioni mund të jepet në format elektronik i marrë nga CD që paraqesin subjektet pranë jush. Në rast se volumi është i madh mund të dërgohen me WeTransfer te ky email, ose mund t’ju vendosim në dispozicion një hard drive të jashtëm.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkpunimin</p>				
3. Nr.1 640 prot	14.02. 2025	<p>Prane Zyres se Komisionerit per te Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit"), eshte depozituar ankesa nr. 590 Prot., date 03.02.2025, nga z. A**** B***, me objekt *Ankim ndaj refuzimit per dhënie te informacionit dhe kopje te dokumenteve zyrtare"*, ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Turizmit che Mjedisit (ne vijim "Autoriteti Publik*).</p> <p>Ankuesi, ne cilesine e kerkuesit, nepermjet email-it date 09.12.2024, depozituar ne adresen elektronike loredana.sulaj@turizmi.gov.al, ka kerkuar t'i vihet ne dispozicion informacioni dhe dokumentacioni, sipas shkreses bashkelidhur.</p> <p>Autoriteti Publik, népërmjet email-it date 06.02.2025, i ka kthyer pergjigje ankuesit lidhur me kerkesën per informacion.</p>	18.02. 2025	<p>Referuar shkresës me Nr. 1640 prot., datë 14.02.2025 ju informojmë se sektori i shqyrtimit teknik të veprimtarive në mjedis, Agjencia Kombetare e Mjedisit nuk ka informacion mbi çfarë është kërkuar në shkresën e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale drejtuar MTM-së.</p> <p>Subjekti kërkuar ka kërkuar Listën e plotë të subjekteve minerare, të cilave u është revokuar licenca III.2.B për vitin 2008-2014 ju informojmë se të gjitha licencat III.2.B janë të publikuara në</p>	Përfunduar	Nuk ka

	<p>Pas pergjigjes se dhene, ankuesi pretendon se është cenuar ne te drejtën per informim, pasi nuk ka marre pergjigje te plote nga Autoriteti Publik per kerkesat per informacion dhe si rrjedhoje i eshte drejtuar Zyres se Komisionerit duke i kerkuar ushtrimin e kompetencave qe i njej ligji per rastet e refuzimit te dhenies se informacionit, si dhe urdherimin e dhenies se informacionit/dokumentacionit te kerkuar.</p> <p>Pas shqyrtimit paraprak te ankesës, sjellim ne vemendjen tuaj se, pika 3 e nenit 3 të ligjit nr. 119/2014 "Per te drejten e informimit", i ndryshuar, (ne vijim "LDI"), parashikohet se: *Çdo person ka te drejte të njihet me informacionin publik, nepermjet dokumentit origjinal ose duke marrë nje kopje te tij ne formën ose formatin qe mundeson akses të plote ne permbajtjen e dokumentacionit".</p> <p>Gjithashtu, bazuar ne piken 2 të nenit 2 te LDI parashikohet se: "informacion publik eshte çdo e dhëne e regjistruar né çfarëdo lloj forme dhe formati, gjate ushtrimit te funksionit publik pavarësisht nese është perpiluar ose jo nga autoriteti publik". Ne këtë kuptim, Autoriteti Publik, pas vlerësimit te kerkeses per informacion nese permbush kriteret per informacion publik sipas dispozites se sipercituar, duhet te vendose ne dispozicion te kerkuesit çdo informacion/dokument, i cili este prodhuar ose mbahet nga ky i fundit ne formen e disponuar.</p> <p>Ne ndjekje te procedures për shqyrtimin administrativ te ceshtjes, Zyra e Komisionerit verëson se, Autoriteti Publik detyrohet sipas nenit 12, 14 dhe 16 te LDI, te informoje ankuesin lidhur me kerkesën e tij ose t'a dergoje até pranë autoritetit kompetent, ne rastet kur nuk e zotëron informacionin, duke vene ne dijeni edhe kerkuesin.</p> <p>Theksojme se LDI ka për qellim te nxise perforcimin e integritetit, transparences e te pergjegjshmërise se autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër jo shteteror, qe ushtron funksione publike.</p> <p>Per sa me siper, Komisioneri kerkon qendrimin tuaj ne lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime per zotërimin e informacionit/dokumentacionit te kerkuar, duke rivleresuar ne kete menyre kerkesën per informacion, brenda</p>	<p>regjistrin kombëtar të lejeve, licencave dhe autorizimeve në QKB në mbështetje të Ligjit Nr. 10081/2009 “Për Lejet dhe Licencat në RSH”, I ndryshuar, VKM Nr. 538/2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare e biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.</p>		
--	---	--	--	--

		<p>dates 19.02.2025. Theksojme se, pergjigja duhet te vendoset ne dispozicion te ankuesit dhe Zyrës se Komisionerit. Ne rast mosveprimit nga ana juaj brenda afatit te percaktuar, Zyra e Komisionerit do të vlerësoje mbi ndjekjen e procedures se metejshme ne perputhje me nenin 18 dhe 24 te LDI.</p>				
4. Nr. 1639 prot	14.02. 2025	<p>Duke u mbështetur ne Ligjin Nr. 119/2014 *Per te dreten e informimit" dhe ne perputhje me nenet e ketij ligji, i cili regullon te drejten e njohjes me informacionin qe prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtohem me keite kerkese per te marre informacionin e meposhtem: A ishte i pajisur me leje mjedisore subjekti “Coca-Cola Bottling Shuiperia” per gjenerimin e mbetjeve me kodet 19 09 04 dhe 19 02 06, dhe a ka ajo kontrata asgjesimi per trajtimin/asgjesimin e tyre me operator te & licensuar? Per sa kohe mund te mbahen keto dy kode mbetjesh nga momenti i gjenerimit te tyre? Bazuar ne detyrimet ligjore per transparence dhe ne te drejten e qytetareve per t'u informuar, presim qe te na mundesoni informacionin e kerkuar brenda afatit te percaktuar nga legjislacioni ne fuqji. Duke ju falenderuar paraprakisht per bashkepunimin, mbetemi ne pritje te nje pergjigjeje sa me te shpejte nga ana Juaj</p>	18.02. 2025	<p>Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse shprehet:</p> <p>Trajtimi i kerkeses nuk eshte ne fushen e veprimtarise se Sektorit juridik.</p> <p>Trajtimi i kërkesës nuk është në fushën e veprimtarisë së Sektorit të Financës</p> <p>Drejtoria e Inspektim-Kontrollit shprehet: Referuar kerkeses per informacion se ardhur nga Emisioni "Piranjat", ju bejme me dije se Sektori i Asgjesimit dhe Pergjegjesise Mjedisore nuk ka kompetence ne proceduren e trajtimit/asgjesimit te mbetjeve nga procesi teknologjik i subjektit "Coca-Cola", pasi ky eshte nje proces qe kryhet periodikisht si kusht i lejes mjedisore qe subjekti disponon dhe jo nje proces ku subjekti kerkon pjesemarrjen tone per asgjesimin e tyre, per kete arsye nuk kemi informacion lidhur me kete kerkese.</p> <p>Sektori I Inspektimit ne Mjedis shprehet: Nga verifikimi ne sistemin online “E-Inspektimi”, rezulton se subjekti “Coca-Cola Bottling Shqiperia” shpk eshte inspektuar nga Agjencia Rajonale Tirane, Durres, Diber dhe nga verifikimi i dokumentacionit ne terren ka rezultuar</p>	Perfunduar	Nuk ka

				<p>se ky subjekt ka kontrata per evadimin e mbetjeve qe gjeneron me subjektet "Eco Empire" shpk, PF "Flamur Lahi" si dhe "Saubermarcher" shpk.</p> <p>Drejtoria e Lejeve Mjedisore dhe VNM shprehet:</p> <p>Ne pergjigje te kerkeses suaj regjistruar ne Agjencine Kombetare te Mjedisit, me Nr. 1639Prot., date 14.02.2025, me lende: "Kerkesë per informacion" Ju bejme me dije se: Operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod II.B. IL.IC jane te publikuara ne Regjistrin Kombetar te Autorizimeve, Lejeve dhe Licencave no QKB, bazuar ne ligin Nr. 10081 date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise".</p> <p>Ne linkun e mëposhtem mund te verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III. I per ndikimin ne mjedis si dhe licencat e nënkategorise III.2.B:</p> <p>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/ Menaxhimi i mbetjeve kryhet ne zbatim te ligjit Nr.10463 date 22.09.2011 *Per menaxhimin e integruar te mbetjeve."</p>		
5. Nr. 1903 prot	21.02. 2024	<p>Në kuadër të asistencës ligjore që jemi duke ofruar për një klient, lutemi nëse do të kisha një përgjigje të shkurtër lidhur me sa më poshtë:</p> <p>Në rastin e një prodhuesi pijesh të ambalazhuara me shishe qelqi: Subjekti në fjalë synon të krijojë një cikël të mbyllur ripërdorimi të shisheve, pra duke i mbledhur ato nga restorantet pasi të jenë të përdorur, për t'i larë dhe ripërgatitur</p>	27.02. 2025	<p>Në përgjigje të email tuaj datë 21.02.2025 me lëndë "Pyetje rreth ripërdorimit të shisheve të qelqit" Ju bëjmë me dije se: Referuar ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" ku termi "Mbetje" përkufizohet çdo substancë ose objekt, të</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>për ripërdorim. A do të nevojitet licencë për transportin e këtyre shisheve? Apo shishet e destinuar për ripërdorim nuk do të konsiderohen mbetje?</p> <p>Do e vlerësonim një përgjigje nga ana juaj brenda një kohe të arsyeshme.</p>		<p>cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë, dhe për zbatimin e tij kërkohet që të na vihet në dispozicion një relacion i detajuar i procesit të punës që do të ndiqet. Gjithashtu ju sjellim në vëmendje se transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve.</p>		
6. Nr. 2198 prot	26.02. 2025	<p>Lutem për piken 3 të kërkesës për informacion, me prioritet kontributin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në baze të të dhënave zyrtare vjetore që publikohen,</p> <p>Me pas procedojmë me përgatitjen e një draft përgjigjeje nga ana e MTM për kërkesën e informacionit, Kjo është një kërkesë për informacion dhe konkretisht,</p> <p>1. Mbështetur në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (2020-2035), kërkoj kopje të studimeve të fizibilitetit, të kryera në mbështetje të planeve rajonale për çdo zonë të menaxhimit të mbetjeve.</p> <p>2. Për qarkun e Tiranës, ju lutem të më vini në dispozicion planin rajonal të menaxhimit të mbetjeve, me objektiva të ndara, sipas bashkive të qarkut, së bashku me Deklaratën nga titullari i Ministrisë së Mjedisit (siç Ligji Nr 52, 2013 VSM e kërkon, në nenin 2 dhe 7.)</p> <p>3. Bazuar në VKM 418, dt. 25. 6. 2014, ku kërkohet që njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 31 dhjetor 2020, të përgatiten për ripërdorimin dhe për riciklimin e mbetjeve (deri në 50% të sasisë së 2014), kërkoj: sa bashki kanë përfunduar ndarjen e mbetjeve sipas rrymave dhe nëse jo, çfarë masash ka marrë MTM?</p> <p>4. Bazuar në kërkesat e ligjit nr. 10 463/2011, i ndryshuar, veçanërisht në nenin 10-13, lidhur me hartimin e dokumenteve politike të menaxhimit të mbetjeve (plan kombëtar, rajonal,</p>	27.02. 2025	<p>Ne përgjigje të kërkesës së mëposhtme ju bejme me dije se:</p> <p>Ne kuader të realizimit të komponenteve të projektit "Menaxhim i Modernizuar dhe Miqësor ndaj Klimës i Mbetjeve dhe Reciklimit", Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me GIZ ka realizuar ushtrimin e peshimit të mbetjeve në të gjithë vendin dhe në ato rajone ku nuk peshoheshin mbetjet. Në këtë kuader është përgatitur një raport mbi mënyrën e menaxhimit të mbetjeve nga bashkitë për vitet 2020-2021-2022 në të cilin do të gjeni bashkelidhur.</p> <p>Situata aktuale në Shqipëri me raportimin e të dhënave parashikon vetëdeklarim drejtpërdrejt nga bashkitë në AKM (bazuar në VKM nr. 687/2015, e ndryshuar me VKM nr. 538/2021), detyrë kjo që i ka kaluar AKEM.</p> <p>Nëse u nevojiten të dhëna për vetdeklarimet e bera nga Njesitë e Qeverisjes Vendore për vitin 2024 të cilat janë grumbulluar nga AKEM, i gjeni bashkelidhur në tabelën excel.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		vendor), kërkoj Planin Rajonal të qarkut Tiranë, i cili miratohet i shoqëruar me deklaratën e titullarit të MTM. Nëse nuk është miratuar, ju lutem më jepni arsyet e mosmiratimit, katër vite pas hartimit të planit kombëtar (2020 -35).		Bashkëlidhur dërguar tabela excel dhe material pdf mbi të dhënat për mbetjet bashkiake si bazë për zhvillimin e politikave dhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve për qytetarët		
--	--	---	--	--	--	--